

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

**06.04.2021  
Ora 11:05**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.11, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr.193, dt 31.04.2021 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupit të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, subjekti ankues PDIU” .**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PDIU, LSI

**Z. K. Bele:** Përshëndetje, çelim shqyrtimin e çështjes nr.11 të subjektit PDIU. Siç jeni njoftuar KAS ditën e shtunë vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim dhe sot kemi seancën për këtë qëllim. Çështja drejtohet nga unë Koli Bele relator i përzgjedhur sipas shortit. Verifikojmë prezencën e palëve. Ju lutem prezantohuni!

**Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së:** Përfaqësuesi i PDIU-së, ankuesi në këtë rast, Shkëlqim Sulo.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Përfaqësuesi i LSI-së, Altin Kaziaj pala e interesuar në këtë rast zoti Relator, të nderuar anëtarë.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** Përfaqësuesi i LSI-së, Kreshnik Kolndreu. Jemi dy sot.

**Z. K. Bele:** Prezent është administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Keni ndonjë kërkesë paraprake lidhur me KAS-in, përbërjen e KAS-it? Mirë, atëherë në këto kushte ftojmë ankuesin të paraqesë shkurtimisht ose si ta vlerësojë, pretendimet e tij dhe provat, nëse ka.

**Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së:** Faleminderit, zoti Kryetar, PDIU i është drejtuar KAS-it me ankimin duke kërkuar kundërshtimin e Vendimit nr.193 datë 31.03.2021 "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupit të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021". Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm të KQZ-së dhe caktimin e partisë së mësipërme PDIU të marrë pjesë në short. Siç e kemi paraqitur dhe në kërkesën ankimore në 31 mars 2021 nga Administrata e KQZ, te Komisioneri është paraqitur projektvendimi "Për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021". Një akti i cili ishte formuluar dhe sjellë në mënyrë korrekte me ligjin duke referuar nenet përkatëse 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, duke ju referuar dhe vendimit 555 datë 26.07.2017 ku KQZ ka shpallur rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të datës 25 Qershor 2017 për Kuvendin e Shqipërisë ku janë përcaktuar mandatet përkatësisht PS 74, PD 43, LSI 19, PDIU 3 dhe PSD 1. Për ekonomi gjyqësore zoti Kryetar shkurtimisht po e paraqes këtë ankim, pra siç është theksuar dhe në paragrafin 2, 3 të udhëzimit nr.5 të Komisionerit datë 06.03.2021, për procedurat e hedhjes së shortit është përcaktuar se partia PDIU dhe LSI përmbushin kriterin e numrit të

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

mandateve dhe u lind e drejta të bëhen pjesë e shortit, për të caktuar anëtarin e 4 të VNV-ve. Në seancën e zhvilluar në 31 mars Komisioneri e ndryshon këtë vendim të sjellë po vetë nga ana e tij dhe me arsyetimin se PDIU është në koalicion me PD ajo nuk ka të drejtë të përcaktojë anëtarin e 4 të VNV-ve, sepse do të bëhet nga partia e parë e koalicionit. Analizën tonë ne e kemi bërë duke ju referuar nenit 65 i cila flet për koalicionet shkurtimisht, marrëdhënie midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimeve përkatëse reciproke. Midis tyre rregullohen me marrëveshje të koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga KQZ. Siç kam theksuar marrëveshja midis PDIU-së dhe PD-së dhe në asnjë rast në këtë marrëveshje nuk është përcaktuar që ne na hiqet e drejta e caktimit të një anëtari pasi ne jemi parti parlamentare. Kjo ka qenë dhe pika ku Komisioneri ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi. Edhe sot e kësaj dite, unë nuk e kam të arsyetuar vendimin që ne ankimojmë por pak a shumë thelbin e dimë. Në Kodin Zgjedhor në nenin 183 është përcaktuar një dispozitë kalimtare vetëm për formimin kalimtar të organeve drejtuese dhe të administratës zgjedhore. Në pikën 8 është cituar saktësisht “Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet paravendore pas hyrjen në fuqi të këtij ligji, e drejta e propozimit të anëtarëve të KZAZ, KQV dhe GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të 2017 dhe konfigurimit shumicë, pakicë të Kuvendit me çeljen e tij menjëherë mbas këtyre zgjedhjeve”. Sjell në vëmendje të këtij Komisioni dhe vendimin e KQZ-së të datës 12.06.2017 ku me shumicë të 5 anëtarëve në një rast të ngjashëm është vendosur se PDIU-së t’i krijohet mundësia e caktimit të një anëtari të grupit të numëimit. Interpretimi që ka bërë Komisioneri ka shkelur nenin 19 të Kodit Zgjedhor ku janë përcaktuar shumë qartë kompetencat e Komisionerit ku citohet se “Kujdeset për zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniform nga të gjitha institucionet subjektet dhe personat e ngarkuar me detyra

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021**

dhe detyrime sipas ligjit”. Në këtë këndvështrim përveç se ka bërë rolin e një opinionisti duke mbajtur anën e një pale, e një subjekti zgjedhor, i ka mohuar të drejtën ligjore një subjekti tjetër zgjedhor që është PDIU. Vlen të theksohet se sigurimi i zbatimit të parimit politik në përbërjen e grupeve të numërimit të votave parashikuar tek neni 29 neni 95, 96 të ligjit me ndryshimet përkatëse. Po t’i referohet raportit të OSBE/ODIHR të 2015 ka qenë një nga shqetësimet ku është përcaktuar se ky subjekt zgjedhor PDIU ka humbur një mandat vetëm për këtë fakt. Pasi thamë ne që ti qëndrojmë të gjithë argumentimit të bërë në kërkesën ankimore dhe referuar ligjit kërkojmë ndryshimin e këtij vendimi dhe caktimin e subjektit PDIU për qenien në short për caktimin e një nga numëruesit e 4 të grupit të numërimit. Prova që ne kemi paraqitur, që mbështesin këtë ankim është vendimi i Komisionerit 193 datë 31.03.2021, vendimi i KQZ nr.555 datë 06.07.2017, udhëzimi i Komisionerit Shtetëror nr.5, 06.03.2021, vendimi i KQZ 12.06.2017, të cilat janë akte që kanë dalë nga institucioni i KQZ, faleminderit.

**Z. K. Bele:** Po, faleminderit nëse keni për lehtësi vendimin e 2017 do të na ndihmonit!

**Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së:** Po, e kam bashkëngjitur në ankesë.

**Z. K. Bele:** Po faleminderit.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Mundem, i nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë të KAS, jeni vënë në lëvizje nëpërmjet një kërkesë ankimore nga subjekti në këtë rast kërkues dhe për ta filluar pak nga fundi i asaj që relatoi kolegu, flet për dispozitat kalimtare të nenit 183. Ky nen është shtuar me ndryshimet e bëra së

**Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

fundmi në Kodin Zgjedhor me ligjin 101 dhe 118/2020. I gjithë dokumentacioni që është bashkëlidhur kërkesës ankimore është i fokusuar në kodin e vjetër, të nderuar anëtarë dhe kjo është shumë e rëndësishme për shkak se kemi pasur ndryshime të karakterit organizues, të parashikuara në nenin 65, shtuar pika 3 e tij e cila i heq legjitimitetin të themi një subjekti i cili nuk rezulton të jetë i regjistruar me emër, emër partie, logo, emër kryetari. Ju e keni para jush fletën e votimit të miratuar së fundmi në Kolegjin Zgjedhor, i cili la në fuqi një vendim tuajin nga ku ne shohim se subjekti politik që ka vënë në lëvizje këtë komision nuk mund të legjitimohet, për ta vënë në lëvizje këtë komision. Për shkak se kërkon një të drejtë, një diçka që ia ka deleguar partisë udhëheqëse të koalicionit sipas referimit të pikës 3, të nenit 65, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Pra, të nderuar anëtarë fillimisht kërkojmë nga ana juaj të shpreheni mbi legjitimitetin përpara se ne të relatojmë ato që janë argumentë ligjorë, pse kjo kërkesë nuk duhet të merret parasysh dhe se nuk është e bazuar në ligj dhe në normat e Komisionit Rregullator. kështu që nuk mund të merren në këtë rast precedentë të mëparshëm nga momenti që ligjvënësi ka vënë një dispozitë, e cila i delegon të drejtat dhe detyrimet nëpërmjet një marrëveshje të brendshme, që është një akt privat midis partisë, i delegon një partie udhëheqëse...

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021**

Do doja nga ana juaj të gjenim mundësinë për t'u shprehur lidhur me formën dhe me legjitimitetin e subjektit që ju ka vënë në lëvizje. Në qoftë se është subjekti i legjitimuar për t'u vënë në lëvizje ndërkohë që shohim se këtu në panel nuk është partia udhëheqëse e koalicionit që shikoni në numrin 9 të fletës së votimit, është shumë e qartë që Partia Demokratike ka marrë të gjitha tagrat për të disponuar në emër dhe në interes të partive të tjera të përfshira në koalicion, faleminderit.

**Z.Sh.Sulo, përfaqësues i PDIU-së:** Në lidhje për sa i përket legjitimitit të palës sonë.....

**Z. K. Bele:** Për të vazhduar seancën sipas rendit, për parim ju bëni parashtimet tuaja, ne mund të bëjmë pyetje...

**Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së:** Ishte një saktësim dhe tërhiqem. Neni 124 i Kodit Zgjedhor “çdo parti politike pjestar ose jo e një koalicioni e të tjera, që çënojnë interesat e tyre të ligjshme brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ka të drejtën e ankimimit”. U dëgjua dhe u tha që ne nuk jemi subjekt zgjedhor, sepse nuk jemi regjistruar në KQZ. Është një vendim i muajit mars, në fillim të marsit në KQZ që subjekti zgjedhor Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet është i regjistruar. Administrata na ndihmoi, është i regjistruar me vendim.

**Z. K. Bele:** Ne ju kemi kaluar në seancë, pra nuk është momenti që të diskutojmë legjitimitimin aktiv. Megjithatë secila palë mban qëndrimet e veta. Ne ju dëgjojmë me shumë vëmendje edhe ju respektojmë pavarësisht nga çfarë mendimi pro apo kundër kemi me njëri-tjetrin.

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

**Z. K. Kolndreu, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë të KAS-it. Doja të shpjegoja se Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet është në koalicion paraprak me Partinë Demokratike. Nuk gjendet fare në fletën e votimit dhe nuk arrij të kuptoj se çfarë votash do të numërojë Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet i bie të numërojë votat tona se faktikisht janë në koalicion paraprak, është Partia Demokratike udhëheqëse e kësaj partie. Po të dilnin në fletë votimi të vetëm dhe mund të kishin këtë të drejtë po në këto lloj kushtesh që jemi, nuk mund të lejoj që Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet të numërojë votat tona, faleminderit.

**Z. K. Bele:** Keni ndonjë pyetje?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në qoftë se më lejon zoti relator, ishte vetëm në kuadrin e shprehjes së këtij komisioni lidhur me legjitimitetin. Pastaj nuk kam mbaruar për sa i përket pjesës së relatimit të parashkrimeve të depozituara që ju keni prezent në dosjet tuaja.

**Z. K. Bele:** Keni argumente apo shtesë? Mundohuni të jeni koncizë, në ndryshimet i kemi para.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Duke filluar nga ajo që kolegu tha lidhur me regjistrimin nuk mjafton që regjistrimi i një subjekti politik të kalojë vetëm ndërmjet filtrit të parashikuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor. Regjistrimi që kulmon me logimin dhe me përmbajtjen e të dhënave të subjektit të emrit të logos, të numrit, të emrit të kryetarit dhe të kandidatëve të vetë në pjesën e fletës së votimit, shkon nëpër disa etapa të tjera. Ato etapa janë fare të qarta në Kodin Zgjedhor dhe parashikonin në nenin 67 dhe 72, pika 1 dhe 2. Këto veprime nuk

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

janë ndërrmarë. Pra, vetë PDIU e dinte që do futej, ishte në diskutime paraprake me partinë më të madhe të opozitës për të qenë pjesë e një koalicioni dhe nuk e ka ushtruar atë që është detyrimi vetë për të sjellë listën shumëmemërore është shumë e rëndësishme. Ashtu siç është i rëndësishëm fakti që nuk kanë mbledhur firmat PDIU për të treguar që është një parti parlamentare ashtu siç ka bërë Lëvizja Socialiste për Integrim që i ka kaluar të gjitha këto etapa dhe sot rezulton të jetë në numrin 6 të fletës së votimit. Për qartësi të faktit nuk është vetëm neni 64 që parashikon regjistrimin e një partie. KQZ-ja e regjistron formalisht në bazë të disa dokumenteve formale që sjell. Por, duhet të përmbushë dhe kushtet që sapo unë thashë, në mënyrë që të rezultojë të jetë garuese dhe në fletën e votimit për të marrë votat e mbështetësve të saj. Ashtu siç thashë në vitin 2020, kemi pasur ndryshime të theksuara të nenit 65, pika 3, çfarë thotë kjo normë, “Në momentin e regjistrimit koalicionit duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji të gjitha të drejtat e detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore, përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”. Pra, ashtu siç edhe në pjesën e shqyrtimit administrativ nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili ka kulmuar me vendimin nr.193, datë 31.03.2021, Partia Demokratike nuk e ka ushtruar këtë të drejtë. Nuk ka qenë prezente për të mbajtur qëndrim aktiv ose pasiv, lidhur me këtë akt të sjellë nga Komisioneri i cili në brendësi të vetë ka relatuar faktin që duke qenë se PDIU nëpërmjet një marrëveshje bëhet pjesë e një koalicioni me një parti tjetër udhëheqëse. Automatikisht PDIU-së i humbasin të gjitha të drejtat për sa i përket kësaj pjese për të cilën ne jemi mbledhur sot përpara këtij komisioni. Vlen të theksohet fakti që në referencë të vendimit 172, mars 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrim Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, nga të gjitha partitë bashkë koalicione për

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*





**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021**

zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021. Në këtë disponohet se në shkresë me nr.Prot 1482, datë 24.02.2021, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërmendura nëpërmjet një kërkesë të bërë nga partia përfaqësuese që parashikon në paragrafin e tretë të nenit 65, Partia Demokratike kërkon regjistrimin e koalicionit. Pra, të gjitha veprimet aktive kundrejt këtij institucioni që është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, janë bërë vetëm nga Partia Demokratike në respektim të normës që sapo citova. PDIU nëpërmjet përfshirjes në këtë koalicion ka pranuar me marrëveshje që të regjistrohet si parti pjesmarrëse duke deleguar tagrat që mund të ushtronte vetë, kryesuesit të koalicionit, pra në këtë rast PD. Mungesa e saj në fletën e votimit si sigël, emër subjekti, emër kryetari dhe mospasja e një liste kandidatësh në 12 qarqe, është tregues i qartë për t'u marrë në konsideratë lidhur me moslegjitimitimin e saj për numëruesit në tavolinën e numërimit. Një marrëveshje të tillë, ky subjekt duhet ta kishte bërë me partinë udhëheqëse dhe jo të kërkonte caktimin e numëruesve nga momenti që elementi identifikues të saj nuk rezultojnë në fletën e votimit. Në ankim subjekti PDIU, duke intepretuar paragrafin e tretë të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, pyet ku është theksuar në marrëveshje që nuk na takon ne e drejta e një anëtari të GNV-së. Gjejmë rastin të sqarojmë këtë fakt duke vënë në dijeni KAS se marrëveshja e parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 65 është një akt në karakter daklarativ për KQZ-në dhe me karakter detyrues për palët që janë të lidhura në të. Një marrëveshje para ose paselektroale në asnjë rast nuk mund të kapërcejë në parashikimin eksplicit të një norme ligjore, përkundrazi fryma e saj dhe përmbajtja duhet të jenë gjithmonë në harmoni me ligjin. Për t'u kthyer te pyetja që sapo parashitrova e cila është pjesë e kërkesës ankimore të bërë nga subjekti PDIU, sqarojmë se në paragrafin e tretë të nenit 65 të Kodit Zgjedhor është shtuar me ligjin 118/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime të Kodit Zgjedhor". Pra, edhe

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021**

praktikat e sjella nga PDIU, nuk mund të qëndrojnë në këtë rast për shkak se kemi një ndryshim të normës të bërë nga ligjvënësi vetëm në vitin 2020. Kjo nuk ka ekzistuar më parë. Lidhur me këtë dispozitë pala pretendon se ka pasur praktikat e mëparshme dhe normalisht këto duhet të rrëzohen nga ana e këtij komisioni. Gjejmë dakordësinë për faktin se kjo është një dispozitë e re dhe ligjvënësi nëpërmjet saj ka hequr legjitimitetin e një subjekti. Nga ky moment që ky i fundit, lidhet në marrëveshje me një subjekt tjetër duke i deleguar partisë udhëheqëse të këtij koalicioni të drejtat dhe legjitimitetin që subjekti po të ishte i regjistruar i vetëm do t'i gëzonte vetë. Pranimi i një subjekti për të lidhur marrëveshje parazgjedhore me një ose disa parti të tjera. Caktimi i një partie udhëheqëse, mospasja e një logo identifikuese, mosdorëzimi i një liste të kandidatëve sipas qarqeve, automatikisht passjell delegimin e kompetencave dhe legjitimitetin të kryesues së koalicionit, i cili ka logon emrin e partisë emrin e kryetarit të partisë dhe listën e kandidatëve si dokumentacion detyrues për regjistrimin sipas afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Në heshtje kjo është pranuar nga partia ankuese në këtë rast. Këto konkluzione i nderuar zoti relator, anëtarë të KAS-it, dalin në përputhje me parimin e bazpeshimit politik në përbërje të grupeve të numërimit të votave dhe të cilat japin balancën midis një procesi të drejtë numërimi dhe një të drejte mbështetur në ligj. Përfundimisht për të mos u zgjatur më tej vlerësojmë se ankimi nuk ka shkaqe të përligjura për t'u pranuar. Mbështetur në nenin 30 pika 1, shkronja "b", të vendimit nr.3 të vitit 2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përfundimisht i kërkoj KAS: Rrëzimin e kërkesës ankimore të subjektit PDIU, lënien në fuqi të vendimit 139, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

**Z. K. Bele:** Faleminderit meqënëse nuk ka pyetje në këtë fazë. Konkluzionin përfundimtar nga pala e interesuar! Ju lutem dhe një herë për procedurë kërkesën përfundimtare nga ana juaj!

**Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së:** Thjesht të bëj një saktësim në sa u dëgjua nga pala e interesuar se çfarë do të bëjë numëruesi i subjektit politik PDIU në po ato veprime të cilat i ka caktuar Kodi Zgjedhor se çfarë bën një numërues. Në lidhje pse nuk është paraqitur përfaqësuesi i PD-së apo subjekti zgjedhor PD, është puna e tyre secili është i pavarur. Thjesht do t'i kërkoja këtij komisioni zbatimin korrekt të Kodit Zgjedhor neni 183, leximit të saktë të paragrafit të tretë të nenit 65. Ne të nderuar kryetar, të nderuar anëtarë, kërkojmë të drejtën tonë ligjore që na njeh ligji si parti parlamentare e ardhur nga zgjedhjet e vitit 2017, ku na lind e drejta të jemi parti e cila të caktojë anëtarin e katërt të grupeve të numërimit nëpërmjet shortit. Pjesa tjetër pastaj çfarë u tha i bie që unë të bie në një përsëritje të gjërave. Përfundimisht zoti Kryetar, ne kërkojmë ndryshimin e vendimit nr.193, datë 31.03.2021, si vendim në kundërshtim me ligjin dhe caktimin e partisë politike PDIU të marrë pjesë në shortin që caktohet për hedhjen e anëtarit të katërt të grupeve të numërimit.

**Z. K. Bele:** Faleminderit, KAS tërhiqet për vendim, do t'u njoftojmë për pak minuta lidhur me vendimin ose nëse do të kemi ndonjë zgjatje të diskutimeve përsëri do t'u njoftojmë që të mos prisni.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.06.04.2021*

**RIFILLON MBLEDHJA**

**ORA 12:00**

**Z. K. Bele:** KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.193, datë 31.02.2021, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara me shumicë votash mbeshtetur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 30 të vendimit nr.3 datës 6.11.2020 të Komisionit Rregullator vendosi:

Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.11, datë 02.04.2021, paraqitur nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Lënien në fuqi të vendimit nr.193 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, faleminderit.

Seanca mbyllet.

**Vendimi nr.20**

**Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI**

